



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, nenit 17, shkronja **b** të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/15, qershor 2008), nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.3, nenit 17, par. 1, 7, 8 dhe 9, nenit 26 të Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 04/L-174, korrik 2013), Udhëzimit administrativ nr. 41, 02/05, për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elemente themelore të planit rregullues, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.05.2017, merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR BLOQET B 17, B 18, B 19 DHE B 20 – LAGJJA “MATI 1” 2017-2025

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Propozimvendimi i Planit rregullues të hollësishëm për bloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 – lagjja “Mati 1” 2017-2025.

Neni 2

Konsultimet publike

Miratimi i Planit të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet pas periudhës së shqyrtimit publik, raportit, analizës dhe inkorporimit të propozimeve të dala nga shqyrtimi publik.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Në bazë të Planit rregullues të hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Prishtinës.

Neni 4
Përmbajtja

Plani rregullues i hollësishëm nga pika I e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 5
Kufiri i territorit

Territori i Planit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1" 2017-2025, ka sipërfaqe prej 21.68 ha. Ky plan në pjesën veriore, jugore dhe perëndimore kufizohet me lagjen "Mati 1", ndërsa në pjesën lindore kufizohet me lagjen "Mati 2".

Neni 6
Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 të Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili e ka hartuar Planin rregullues të hollësishëm.

Neni 7
Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku 8-vjeçare.

Neni 8
Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të originalit.

Neni 9
Organet për zbatim

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Organet e tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Plani, nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 - 020/01 - 0142459/17, më 14.06.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halim, jur. i dipl.

ARSYETIM

I VENDIMIT PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR BLLOQET B 17, B 18, B 19 DHE B 20 - LAGJJA "MATI 1" 2017-2025

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për planifikim hapësinor 04/L-174, dhe në kërkesat e pronarëve të tokave brenda blloqeve B 17, B 18, B 19, B 20 në lagjen "Mati 1", marrëveshjeve të arritura mes tyre dhe investitorëve, Komuna e ka parë të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20", i cili plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e gjashtë, të mbajtur me dt. 29.09.2016, ka marrë vendim për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 - lagjja "Mati 1" dhe vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në neni 11, pika 1.6.1 të Ligjit nr. 04/L-174 përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore, ka emëruar ekipin profesional, i cili ka hartuar Planin rregullues të hollësishëm, duke e inkuadruar me modifikimet e duhura edhe propozimin e bllokut "Kodrina".

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, është zonë e përcaktuar në bazë të Planit zhvillimor komunal, i miratuar nga Kuvendi i Komunës, me nr. 01-031-156871, dt. 27.08.2013 dhe me Planit zhvillimor urban, i miratuar nga Kuvendi i Komunës, me nr. 01-035-181427, dt.24.09.2013. Kjo zonë gjendet brenda Planit rregullues "Mati 1", i miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 35-18186, dt. 03.08.2005, i plotësuar dhe ndryshuar sipas Vendimit 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010 dhe Vendimit 01. nr. 031-1678, dt.20.07.2011.

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej $S= 21.68$ ha, e cila zonë përfshinë pjesën e zgjidhjes urbane të "Kodrinës" dhe një pjesë tjetër në pjesën jugore të këtij plani (shih ekstraktet e bashkëlidhura). Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonës kadastrale Matičan.

Plani rregullues i hollësishëm ka përcaktuar kushtet ndërtimore sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor 04/L-174 dhe Udhëzimit administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të Planit rregullues nr. 41, 02/05 (Bazuar në interpretimin e dhënë nga MMPH-ja).

Projektplani rregullues i Hollësishëm është finalizuar dhe Komuna ka përgatitur draftin për ta lënë në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim.

Duke u bazuar në nenin 7, pika 2 të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nr. 05/2014, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, miratoi Vendimin për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 të lagjes "Mati 1" dhe vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Duke u bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 05/2014, ky plan më 08.02.2017, është ekspozuar në hollin e objektit të Komunës së Prishtinës, në lagjen " Arbëria", rr. "Ahmet Krasniqi" (objekti i ri i Komunës), në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Pas përfundimit të shqyrtimit publik, sipas Vendimit 01. nr.031/01-0052102/17, dt. 10.03.2017, është formuar komisioni për shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve dhe sugjerimeve për planin të bëra gjatë shqyrtimit publik.

Pas shqyrtimit të vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura nga publiku, ky komision ka përfunduar raportin mbi shqyrtimin publik dhe projektin final të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20, lagjja "Mati 1" 2017-2025, është i gatshëm për miratim në Kuvendin e Komunës.